



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



**Datë: 22.04.2026**

**A.nr.228/2026**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.228/2026, të datës 02.03.2026, të parashtruar nga ankuesi A.M, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1, nenin 16, paragrafi 3, si dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, në seancën për këshillim dhe votim të datës 22.04.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet si e pa bazuar** ankesa me numër A.nr.228/2026, e datës 02.03.2026, të parashtruar nga ankuesi A.M.

## A r s y e t i m

Ankuesit A.M, (*tutje referuar vetëm ankuesit*), më datë 02.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër njoftimit të datës 31.01.2026 të Njesisë për Menagjimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, lidhur me kërkesën për realizimin e kompensimit për funksion shtesë sa i përket emërimit të ankuesit sipas vendimit nr.05-7078 të datës 16.09.2025 dhe Vendimit nr. 05-7082.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 10.03.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa kjo e fundit me datë 18.03.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 1074/2026 të datës 02.03.2026 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 04.12.2025 drejtuar NJMBNJ në MSH; Emalin e datës 30.01.2026; vendimin nr.05-7078 të datës 16.09.2025; Vendimin nr. 05-7082; Akt emërimit e datës 20.12.2024.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e pa bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndë rezulton se ankuesi A.M sipas akt emërimit me numër 20.12.2024, është i punësuar në pozitën e punës Zyrtar i Lartë Ligjor në Divizionin për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit/Departamentit Ligjor.

Sipas shkresave të lëndës konstatohet se ankuesi sipas Vendimit nr.05-7078 të datës 16.09.2025 është emëruar Kryesues i Komisionit të Ankesave lidhur me praktikën dhe provimin profesional për profesionistët shëndetësorë pran MSH dhe sipas Vendimit nr. 05-7082 datë 19.09.2025 është caktuar anëtar i Komisionit për Frytnim të Asistuar Mjekësor, prandaj nisur nga këto vendime ankuesi pretendon se këto duhet të konsiderohen funksione shtese reale pa marrë parasysh që vendimet janë nënshkruar nga Ministri i MSH.

Lidhur me pretendimet e ankuesit Kolegji i këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me theks të veçantë:

- Nenit 1 [Qëllimi] ku përcaktohet se: “2. Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë,
- Nenit 2 [Fushëveprim] ku përcaktohet se: 1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj.”,

Për me tepër, e në kuptim të nenit 38 paragrafi 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Kolegji i Këshillit analizoi kriteret lidhur me përfitimin e pagesës për funksionin shtese sikurse rregullohet me dispozitat e nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.10/2023 për Kompensimin e Funksioneve Shtesë ku përcaktohet se: “Përjashtimisht, kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme: 2.1. themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor; 2.2. përfshirja në komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik; 2.3. funksioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mbanë; 2.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon; 2.5. komisionet/bordet të cilat kanë kompetenca Vendim-marrëse në procedurë administrative; 2.6. komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar”, dhe rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se kjo

dispozitë ka përcaktuar kritere se për tu kompensuar anëtari apo anëtarët e një komisioni në emër të funksioneve shtesë duhet të plotësohen të gjitha parakushtet ligjore së bashku/si tersi, apo thënë ndryshe në frymën e normës juridike në mënyrë kumulative, dhe në rastin konkret nuk janë të plotësuar kushtet e tilla sepse ankuesi është i punësuar në MSH.

Gjithashtu Kolegji lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit është mbështetur në Aktgjykimin P.A.nr.30/2025 të datës 10.12.2025 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës ku thuhet citoj “Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, ka shqyrtuar me kujdes bazën ligjore të aktit nënligjor normativ të kontestuar, përkatësisht nëse dispozitat e kontestuar të: Rregullores(QRK)Nr.10/2023 Për Kompensimin Për Funkcionin Shtesë, dhe Rregullores (MFPT)Nr.02/2023 Për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, janë në përputhshmëri me legjislacionin e zbatueshëm për pagat në sektorin publik, mbi bazën e të cilit janë nxjerrë dhe ka vlerësuar se të njëjtat nuk janë në kundërshtim me parimet dhe frymën e dispozitave të këtij ligji.

Gjykata vlerëson se pretendimet e paditëses, të parashtruara në kërkesëpadi dhe gjatë procedurës gjyqësore, mbeten në nivel deklarativ dhe të përgjithshëm, pa u mbështetur në fakte konkrete, prova relevante apo argumentin juridik të mjaftueshëm.

Në kontekstin e ligjit primar për pagat, Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ky ligj është i qartë në përcaktimin e dispozitave për kompensimin e funksioneve shtesë dhe në kufizimin e këtij kompensimi vetëm për funksione që nuk përfshihen në detyrat bazë të zyrtarëve publik. Neni 38 paragrafi 6 i Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, autorizon shprehimisht Qeverinë që me akt nënligjor, të përcaktojë mënyrën dhe kriteret për realizimin e kompensimit për funksione shtesë. Në ushtrim të këtij autorizimi ligjor, Qeveria ka nxjerrë Rregulloren (QRK)Nr.10/2023 Për Kompensimin Për Funkcionimin Shtesë neni 38 i ligjit përcakton në mënyrë eksplicite që zyrtarët e emëruar për të shërbyer në bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për zyrtaren/in, ky/kjo zyrtar/e publik/e ka të drejtën e kompensimit shtesë për këtë funksion, por ky kompensim nuk përfshin detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga pozita e rregullt të cilën e mban zyrtari, përfshirë pjesëmarrjen në komisionet apo organet e brendshme të institucionit. Kjo mënyrë e rregullimit reflekton një ndarje të qartë mes detyrave themelore të punës dhe angazhimeve apo funksioneve shtesë që kanë të drejtë në shpërblym financiar. Për këtë arsye, dispozita e Rregullores QRK Nr.10/2023, përkatësisht neni 5 [Kriteret për përfitimin], ku është përcaktuar se: “2.Përfshirë, Kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme: “2.6.komisioni/bordi nuk themelohet nga Institucioni ku zyrtari publik është i punësuar” ,përcakton qartë që kompensimi për funksionin shtesë nuk përfitohet kur komisioni apo bordi është themeluar nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar; dhe i njëjti është në harmoni me dispozitat ligjore .Kjo sepse ligji primar lejon qartë diferencimin midis angazhimeve që janë pjesë e detyrave normale dhe atyre që përbëjnë funksion shtesë real, duke shmangur pagesën e dyfishtë për detyra që përbëjnë rregullisht funksionet e zyrtarit publik. Gjykata vlerëson se kriteri i përcaktuar në paragrafin 2.6 të nenit 5, sipas të cilit kompensimi për funksion shtesë nuk përfitohet kur komisioni apo bordi themelohet nga institucioni ku zyrtari është i punësuar, është në harmoni me nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit për Pagat, i cili përjashton nga kompensimi detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga pozita e rregullt e zyrtarit publik, përfshirë pjesëmarrjen në komisione të brendshme. Gjykata vlerëson se ligjvënësi ka lënë hapësirë diskrecionale Qeverinë për të dalluar ndërmjet angazhimeve që përbëjnë funksion shtesë real dhe atyre

*që, për nga natyra e tyre institucionale, konsiderohen pjesë e obligimeve funksionale të zyrtarit. Kriteri i organit themelues përbën një kriter objektiv dhe funksional, i cili synon të parandalojë dyfishimin e pagesave për detyra që kryhen brenda kompetencave të institucionit ku zyrtari është i punësuar. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se kjo dispozitë nuk është diskriminuese dhe nuk tejkalon autorizimin ligjor”.*

Andaj, theksuar si më lart Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda: A.nr.228/2026

**Ilire Mehmeti-Shaqiri**

Procesmbajtëse

**Eshref Shabani**

Kryetar i Kolegjit

### **Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit A.M;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në MSH; dhe
- Arkivit të KPMSHCK -së.